



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR

“PËR TË KOORDINUAR DHE MBIKËQYRUR TË GJITHA VEPRIMET  
INSTITUCIONALE PËR TË LUFTUAR DEZIFORMIMIN DHE FORMAT E  
TJERA TË NDËRHYRJES SË HUAJ NË PROCESET DEMOKRATIKE TË  
VENDIT”



## **DRAFT - OBJEKTIVAT** **E KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR**

### **OBJEKTIVI I:**

I. Rishikimi i kuadrit ligjor dhe i praktikës për ndalimin e ndërhyrjeve të huaja në proceset demokratike dhe ato zgjedhore:

1. Analizimi dhe ofrimi i zgjidhjeve të ndërhyrjeve në proceset zgjedhore: analizimi dhe evidentimi i kuadrit ligjor në mbrojtje të ndërhyrjeve në proceset zgjedhore, duke përfshirë financimet e fushatave dhe financimet e partive politike ose rasteve të lobimit. Kjo përfshin adresimin e rasteve të shpenzimeve politike nga kanalet e paligjshme ose donatorët e rremë nga burime të vendeve me qëllime ndërhyrjesh në proceset politike, zgjedhore, etj..
2. Vlerësimi i kufizimeve kombëtare të financimit politik: Vlerësimi i masave kombëtare që kufizojnë burimet e financimit politik dhe identifikimi i fushave që kërkojnë ndërhyrje për të parandaluar aktorët e huaj që të mbështesin fshehurazi aleatët e tyre nëpërmjet mjeteve të ndryshme financiare.
3. Analizimi dhe rritja e përgjegjësisë kundër ndërhyrjes së huaj: Kontributi në diskutimet se si të rriten përgjegjësitë e autoriteteve publike, kompanive të teknologjisë dhe mediave sociale, si dhe sektorit privat në përgjithësi, për të luftuar ndërhyrjen e huaj dhe dezinformimin.

### **OBJEKTIVI II:**

II. Forcimi i kuadrit ligjor dhe masave institucionale në mbrojtjen e sigurisë kombëtare nga ndërhyrjet keqdashëse:

1. Adresimi i kuadrit ligjor në mbrojtje të cënimit të sigurisë kombëtare nga ndërhyrjet e formave të ndryshme: Identifikimi dhe propozimi i masave për të trajtuar cënimin e sigurisë brenda institucioneve kombëtare dhe atyre në lidhje me BE-në, NATO-n, etj..
2. Analizimi dhe adresimi i funksionimit të institucioneve ekzistuese dhe ato që duhet të krijohen në kuadër të mbrojtjes së sigurisë kombëtare nga ndërhyrjet keqdashëse.
3. Analiza dhe mbrojtja për veprime të koordinuara dhe me partnerët për kërcënimet hibride: Sugjerime për masa të koordinuara në nivel evropian dhe me SHBA-në, për të trajtuar kërcënimet hibride si sulmet kibernetike, operacionet *hack-and-leak*, spiunazhi kibernetik dhe aktivitetet e tjera të dëmshme që nuk mund të trajtohen efektivisht vetëm nga autoritetet kombëtare.

### **OBJEKTIVI III:**

III. Rishikimi i kuadrit ligjor dhe i praktikës për ndalimin e ndërhyrjeve të huaja në ekonomi dhe sektorë të tjerë kritik:

1. Analizimi i kuadrit ligjor dhe praktikës në ndërhyrjet e huaja keqdashëse në investime strategjike, financime të infrastrukturave kritike, procedurave të prokurimit publik etj..
2. Analizimi dhe adresimi i rasteve të ndërhyrjeve të tjera në destabilizimin e ekonomisë, sektorëve të tjerë të saj strategjikë, përfshirë sistemin financiar.

### **OBJEKTIVI IV:**

IV. Mbrojtja dhe promovimi i lirisë së shprehjes, lirisë së medias dhe pluralizmin online dhe offline, aksesin në informacion, rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe nxitja e debatit publik rreth angazhimit kundër dezinformimit:

1. Forcimin e organizatave të shoqërisë civile dhe rritjen e kapaciteteve të mediave të pavarura: për të zbuluar, ekspozuar dhe rritur ndërgjegjësimin e publikut për dezinformimin dhe manipulimin e informacionit.
2. Mbështetje për kërkimin e pavarur të fakteve, raportimin investigativ dhe gazetarinë e këtij lloji në nivel kombëtar, përfshirë dhe në fokus dezinformimin.
3. Mbështetje të organizatave të shoqërisë civile që promovojnë informacion të besueshëm dhe media të lirë, përfshirë edukimin në raport me internetin dhe aftësitë digjitale, duke ruajtur të gjitha liritë themelore.